# Komuna e Drenasit

## Pasqyrat Financiare

## për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2008

**(me raportin e auditorit te pavarur bashkangjitur)**

**KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch**
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telefax +381 38 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

# Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Auditorin Gjeneral

Prishtinë, 1 Dhjetor 2009

Ne u angazhuam të auditojmë pasqyrat financiare bashkëlidhur të Komunës së Drenasit (“Komuna”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008, një krahasim të buxhetit me shumat aktuale, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese. Pasqyrat financiare të Komunës më datë dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2007 u audituan nga një auditues tjetër, raporti i të cilit që daton 29 dhjetor 2008, shprehte një refuzim për të dhënë opinion si pasojë e mungesës së përshtatshmërisë së informacionit financiar, mungesës së saktësisë së informacionit financiar lidhur me aktivet fikse dhe saktësisë dhe plotësisë për të hyrat vetanake, mungesës së procedurave të përshtatshme dhe të besueshme të kontrollit lidhur autorizimin e duhur të shpenzimeve dhe mungesës së barazimit ndërmjet regjistrimeve kontabël dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare të Komunës, si dhe pa-pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

*Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (‘SNKSP’) Bazuar në Paranë e Gatshme *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 2008 /13 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore.* Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

*Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Për shkak të çështjeve të trajtuara në paragrafin 1 të Bazës për Refuzim për të Dhënë Opinion, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencë auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të bazuar një opinion auditimi.

*Baza për Refuzim për të Dhënë Opinion*

1 Komuna duhet të mbajë lista të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në kontabilitet dhe në sistemet operacionale në lidhje me pagesat nga palët e treta, si dhe në mungesë të kontrolleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim ne gjendje të kryenim teste auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për verifikimin e plotësisë së pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008.

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch is a branch of KPMG Albania Sh.p.k., a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International, a Swiss cooperative.

Registered with the Kosovo Business Registration Agency with Business no. 70291840

2 Komuna nuk ka shpalosur në Shënimin 27 të pasqyrave financiare ndonjë shumë për pronat, objektet dhe pajisjet. Gjithashtu, ka një numër mungesash dhe pasigurish që ndikojnë raportimin financiar për pronat, objektet dhe pajisjet e Komunës si më poshtë:

- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.

- Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshire këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.

- Komuna nuk ka krijuar nje komitet vlerësimi për qëllime regjistrimi dhe vlerësimi të pasurive.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve dhe mungesave të tjera të shpjeguara më sipër, ne nuk mundëm të përcaktojmë cfare rregullimesh mund të ishin të nevojshme për informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës.

3 Komuna nuk ka bërë asnjë rregullim në pasqyrat e saj financiare për informacionin krahasues të viteve të mbyllura më 31 dhjetor 2007 dhe 31 dhjetor 2006. Në veçanti, sa më poshtë mungonte ose nuk ishte shpalosur në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare:

- Informacioni krahasues për vitin 2007 dhe 2006 në Shënimet 2 dhe 3 si dhe Shënimi 9 per vitin 2006 nuk barazonin me Nenin 10 *Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme.*
- Informacioni krahasues për vitet 2007 dhe 2006 në Shënimin 27 nuk është paraqitur i plotë.
- Shënimi 28 nuk është paraqitur i plotë për vitin 2007 dhe Shënimet 13 dhe 14 nuk janë paraqitur te plota për vitet 2007 dhe 2006.

Meqënëse për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2007 u refuzua opinioni, informacioni krahasues i përshkruar më sipër mund të ketë anomali materiale.

*Refuzim për të Dhënë Opinion*

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të trajtuara në paragrafin 1 të Bazës për Refuzim për të Dhënë Opinion ne nuk shprehim ndonjë opinion mbi këto pasqyra financiare.

Rishikimi i përputhshmërisë

Përvec auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

*Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare.* Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

*Konkluzion për Përputhshmërinë*

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë auditimit, janë në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

*Cështje të tjera*

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

1 Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Komuna nuk ka implementuar një program të integruar kompjuterik kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacionin për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë.

2 Megjithese Kryetari i Komunës ka nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ishte në gjendje të përgatitste një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.

3 Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, dhe nuk mban lista apo llogari të vecanta për të gjithë debitorët e saj për detyrime të lidhura me taksa të ndryshme. Vetëm arkëtimet në para të gatshme nga të hyrat regjistrohen. Megjithëse llogaritë e arkëtueshme nuk kërkohen të shpalosen në pasqyrat fianciare, mungesa e saktësisë dhe plotësisë së tyre do të ndikojë në të hyrat që Komuna mund të fitojë dhe në aftesinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.

4 Komuna nuk ka mbajtur lista të pagesave nga palët e treta. Evidenca e disponueshme dhe kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për tu siguruar se pagesat nga palë të treta prezantohen dhe menaxhohen në përputhje me legjislacionin përkatës dhe përdoren për qëllimin e synuar nga legjislacioni, ishin të limituara.

5 Ne identifikuam një numër mospërputhjesh me Ligjin Nr. 2003/17 'Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë' (ndryshuar). Këto mospërputhje lidheshin me procedura të kërkuara të cilat nuk ishin kryer dhe dokumentuar nga Komuna.

6 Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundur që pagesa të parasë së gatshme të kërkohen në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka kryer ndonjë proces zyrtar që mund të sigurojë infomacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provigjoneve dhe detyrimeve kontigjente.

KPMG Albania Sh.p.k. Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

*Shënim*

1 Sqarime të mëtejshme për rekomandimet dhe përgjigjet e manaxhmentit për keto sugjerime janë përfshirë në Shtesën 1 të ketij raporti.

2 Një sqarim për forma të ndryshme të modifikimeve të një opinioni auditimi është përfshirë në Shtesën 2 të ketij raporti.

KPMG

# Shtesa 1

# 1 Të përgjithshme

## 1.1 Auditimi për vitin 2008

KPMG Albania Sh.p.k. – Dega Kosovë ("KPMG") është emëruar për te ushtruar auditimin e pasqyrave financiare te Komunës se Drenasit ("Komuna") të përgatitura në bazat e parasë së gatshme në pajtim me SNKSP *Raportimi Financiar në para të gatshme,* për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2008.

Këshilla jonë në këtë dokument kufizohet në konkluzionet e specifikuara në vazhdim dhe e bazuar në plotësinë dhe saktësinë e fakteve të paraqitura më poshtë, supozimeve dhe prezantimeve. Nëse ndonjë prej fakteve, supozimeve apo prezantimeve e përmendura nuk është tërësisht i plotë ose i saktë, atëherë është e domosdoshme që ne të informohemi menjëherë, duke qënë se pasaktësia dhe mungesa e plotësisë mund të kenë një efekt material në konkluzionet tona. Për dhënien e këshillës sonë, ne mbështetemi në dispozitat relevante të legjislacionit aktual në Kosovë, rregullave dhe interpretimeve juridike dhe administrative të saj. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve, në mënyrë retroaktive dhe/ose prospektive dhe ndryshime të tilla mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e konkluzioneve tona. Ne nuk do të përditësojmë këshillat tona për ndryshimet ose modifikimet e mëvonshme të legjislacionit dhe rregulloreve, ose të interpretimeve juridike apo administrative të tyre.

## 1.2 Pasojat

Raporti ynë është planifikuar të përfshijë rekomandime të dobishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave të kontabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe kontabilitetit të Komunës si dhe në shmangien e dobësive që mund të çojnë në humbje materiale ose në gabime. Ky raport është i hartuar vetëm për informim dhe përdorim nga ana e menaxhmentit të Komunës, zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Asambleja, dhe nuk duhet të përdoret nga asnjë palë tjetër që nuk është e specifikuar. Është detyrimi juaj të ndërmerrni veprimet e nevojshme për korrigjimin e dobësive dhe nëqoftë se ju dështoni në të, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për humbjet apo gabimet që mund të ndodhin si rezultat.

## 1.3 Përjashtimi i mashtrimit

Siç kemi rënë dakord, ju gjithashtu keni pranuar që për arsye të rëndësisë në punën tonë të informacionit dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Komuna, drejtuesit e saj, punonjësit apo agjentët ju, përveç rasteve të neglizhencës, keqbesimit ose pakujdesive të paramenduara, nuk do të na quani përgjegjës ose fajtorë për ndonjë humbje ose të tjera pasoja në qoftë se informacioni i rëndësishëm për punën tonë na është mbajtur apo fshehur me qëllim, ose na është paraqitur në mënyrë mashtruese.

## 1.4 Struktura e këtij raporti

Çdo kategori e vëzhgimeve është e përshkruar në një faqe të veçantë. Për çdo vëzhgim struktura është: *vëzhgimi dhe statusi aktual nese eshte e aplikueshme, rreziku, rekomandimi dhe përgjigja e menaxhmentit.*

# 2 Çështjet e ngritura gjatë vitit aktual

## 2.1 Përgatitja e Pasqyrave Financiare

### 2.1.1 Vëzhgimi

Informacion parësor në të cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është Free Balance. Edhe pse Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në një program lokal kontabiliteti të bazuar në Access, ky sistem nuk përdoret për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Megjithëse Kryetari i Komunës ka nënshkruar Deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhën angleze dhe serbe përpara fillimit te auditimit. Gjatë periudhës së auditimit ne shpenzuam kohe dhe burime të konsiderueshme në asistimin e Komunës për të përmirësuar prezantimin e pasqyrave financiare në gjuhën angleze. Sidoqoftë Komuna nuk ishte në gjendje të dorëzonte një draft final të pasqyrave financiare në serbisht në fund të auditimit tonë.

Për me tepër, informacioni në vijim që kërkohet të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është i regjistruar në Free Balance dhe nuk është pjesë e një softueri të integruar kontabiliteti:

- Pagesat nga palët e treat
- Pronat e patundshme dhe pajisjet,
- Faturat e papaguara (detyrimet)

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet e kontigjente.

Si pasojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Neni 16 Shënimi 27. Pasuritë Jo-financiare
- Mund te kete pagesa te konsiderueshme nga palet e treta, per shembull raste kur nje pale tjeter si nje ministri apo donator i huaj blejne/kontribuojne nje pasuri per perdorim nga Komuna, dhe kjo per shkak se nuk eshte e regjistruar ne Free Balance nuk eshte as e prezantuar ne pasqyrat financiare
- Shënimi 13. “Te hyrat vetanake” nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit administrativ Nr 2008/13. Komuna nuk i ka kategorizuar të hyrat vetanake sipas atyre të përcaktuara me udhëzim, por ka përdorur kategoritë e saj të brendshme për të shpalosur këtë informacion.
- Shënimi 13.1 “Te hyrat vetanake – të hyrat nga taksa administrative”. Duke qenë se shënimi 13 nuk është plotësuar në përputhje me urdhëresën administrative 2008/13, Shënimi 13.1 i cili detajon më tej të ardhurat tatimore administrative, nuk është plotësuar. Gjithsesi detajet e kërkuara në shënimin 13.1 janë shpalosur në shënimin 13.

- Informacioni krahasues i paraqitur në shenimet 2 dhe 3 për vitet 2007 dhe 2006 dhe në shenimin 9 për vitin 2006 nuk barazon informacionin në Seksionin 10 Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme.
- Informacioni krahasues qe duhej te prezantohej në shënimin 27 mungon për vitin 2007 dhe 2006.
- Shënimi 28 nuk paraqitet i plote për vitin 2007 dhe Shënimet 13 dhe 14 nuk paraqesin infomacion te plote për vitet 2007 dhe 2006.

### 2.1.2 Rreziku

Mangësitë ne kontrollet e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe gabimeve si në vijim:

- Plotësia dhe saktësia e informacionit financiar;
- Integriteti i të dhënave;
- Ruajtja e pasurive; dhe
- Mungesa e regjistrimit te pagesave nga pale te treta mund te rezultoje ne pasuri/sherbime te perdorura pa qera nga pale te tjera, te ndryshme nga Komuna

### 2.1.3 Rekomandimet

Përgatitja e pasqyrave financiare te Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për të siguruar që informacioni i kërkuar eshte regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt ne pasqyrat financiare.

### 2.1.4 Përgjigja e Menaxhmentit

Sa i përket regjistrimit të të hyrave, formulari 'OSR' është formular i derguar nga Ministria e Financave dhe raportimi bëhët me ketë formular ne baza mujor tre, gjashtë, nëntë mujore si dhe raporti vjetor ku perfshihen te gjitha fushat nga të cilat vjelim te hyra. Shenimi ne pasqyrat financiare nuk i perfshin të gjitha fushat e vjeljes së të hyrave andaj nese nuk do ta kishim perdorur këtë formular, tabela në pasqyrat financiare nuk do të ishte komplete.

Ndersa faturat e pa paguara janë paraqitur në pasqyrat financiare si dhe për rastet ne procedur gjyqësore është paraqitur shuma e cekur prej EUR 6,522.00 ne tabelën e detyrimeve kontigjente neni 17 shenimi 29.

## 2.2 Menaxhimi i Pronave të patundshme dhe pajisjeve

### 2.2.1 Vëzhgimi

Komuna nuk ka një regjistër të pronave të patundshme dhe pajisjeve në posedim të saj.

Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të patundshmërive, përfshire këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e patundshmërisë, dhe informacion për statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Kadaster ose në Gjykatë..

Komuna nuk ka përcaktuar një komitet vlerësimi për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive.

Ne nuk u pajisëm me një dokument të saktë e të përshtatshëm numërimi fizik të mjeteve më 31 Dhjetor 2008 dhe si pasojë nuk ishte e mundur të bënim një verifikim të të dhënave në kontabilitet me të dhënat e numërimit fizik. Dokumentet e numërimit fizik përmbanin vetëm informacion të limituar në lidhje me mobiljet dhe pajisjet, barkodet e pajisjeve dhe të dhëna mbi personat qe i përdorin këto pasuri. Komuna nuk ka kryer një numërim fizik të pronave të patundshme.

Për shkak te natyrës së këtyre të dhënave, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- shpalosë informacionin e kërkuar mbi pronat, objektet dhe pajisjet ne pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2008 dhe me 31 Dhjetor 2007; dhe
- të sigurojë barazimin e informacionit të regjistruar në kontabilitet me tabelat e vleresimit ose me ndonjë analize tjetër, perpara aprovimit te pasqyrave financiare.

### 2.2.2 Rreziku

Mungesa e një regjistri gjithpërfshires të pronave, objeketeve dhe pajisjeve dobëson kontrollet e brendshme mbi këto të fundit, dhe mund të çojë deri në keqpërdorim të pasurive si dhe në mos identifikimin e këtyre keqpërdorimeve në kohën e duhur. Për më tepër, menaxhmenti mund të humbasë kohë dhe përpjekje për të identifikuar detajet dhe vlerën e mbartur të aktiveve gjatë proceseve vendim-marrëse.

Komuna mund të mos jetë në gjendje të kontrollojë shfrytëzimin aktual të pasurisë së saj nga palët e treta dhe si pasojë mund të mos i mbledhë të hyrat nga qiraja nga këto patundshmëri.

Si pasojë e natyrës se regjistrimeve të saj dhe mungesës së vlerësimit të duhur të aktiveve të saj, Komuna mund të mos jetë në gjendje të pajtohet me kërkesat per raportim.

### 2.2.3 Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:

- Te mbaje një regjistër gjithëperfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve.

- Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur të çertifikuar është e rekomandueshme dhe praktika më e mire në raste të tilla.
- Të kryejë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e aktiveve dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe në regjistër.
- Të bëjë përpjekje shtesë në lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive.

### 2.2.4 Përgjigja e Menaxhmentit

Komuna ka formuar komisionin për inventarizimin dhe vleresimin e pasurisë sipas instruksionit administrativ 2005/11. Vendimi per inventarizimin dhe vleresimin e pasurise daton me 15 Dhjetor 2008.

## 2.3 Të hyrat

### 2.3.1 Vëzhgimi

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin mbi pronën. Komuna nuk regjistron të dhëna faturimi për tipet tjera të të hyrave. Per kete tip te hyrash jane regjistruar vetem ato ne para te gatshme.

- *Mbledhja e të hyrave.* Përveç tatimit mbi pronën, menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra ose listë për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksa të ndryshme. Pa të dhëna të detajuara, të mjaftueshme dhe të sakta për debitorët, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë për koeficientët e mbledhshmërise së të hyrave, apo të përcjellë mbledhjen e të hyrave vetanake në kohën e duhur.

- *Barazimi i te hyrave.* Zyra e Taksës Administrative, Zyra e Kadastrit, Zyra e Pronës dhe Qirasë dhe Zyra e Planifikimit Urbanistik nuk kanë bërë ndonjë barazim të të hyrave të arketuara me departamentin e kontabilitetit. Ne nuk na është dhënë një listë e detajuar e të hyrave të arketuara nga Zyra e Kadastrit dhe Zyra e Taksës Administrative.

- *Te hyrat nga licencat e biznesit.* Komuna nuk komunikon me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ('MTI') në mënyrë që të marrë numrin e bizneseve aktive në Komunë. Si pasojë, biznese joaktive ose të mbyllura mund të faturohen, ndërsa bizneset aktive mund të mos faturohen.

### 2.3.2 Rreziku

Ndërsa për të arkëtueshmet nuk kërkohet shpalosja në pasqyrat financiare, mungesa e saktësisë dhe plotësisë se tyre do të ndikojë mbi të hyrat që Komuna mund të fitojë.

Kontrolle jo të përshtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat, softuerin dhe sistemin e faturimit, rrisin rrezikun e manipulimit të të dhënave dhe keqpërdorim të informacionit. Një sistem i tille mund të çojë në faturim jo të plote dhe të hyra jo të plota.

Regjistrimi manual dhe mungesa e lidhjes së sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyre automatike, e ekspozon Komunën ndaj një rreziku gabimi shtesë. Për më tepër, kjo shkakton kosto shtesë për mbajtjen e të dhënave, rishikimin dhe barazimin e informacionit.

Një listë e detajuar dhe e përditësuar e tatim paguesve, bizneseve aktive dhe debitorëve të gjeneruar nga sistemi është me rëndësi të veçantë në situatën e tanishme ku komunat nuk e regjistrojnë secilin transaksion individual në Free Balance. Si pasojë, përveç se për tatimin mbi pronë, Thesari dhe Komuna, nuk kanë një listë të detajuar të gjeneruar nga sistemi i kontabilitetit ose sistemi i faturimit. Si rezultat i kësaj, nuk është e mundur të bëhen barazimet e nevojshme ose analiza sipas debitorëve..

### 2.3.3 Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, eficiente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mëdha dhe sigurimin që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë mbartur siç duhet. Ne i rekomandojmë Komunës të konsiderojë pikat si në vijim:

- Implementimin e një sistemi faturimi që te përfshijë detaje të azhornuara për paguesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pagues. Qasje në informacion të tillë duhet të kenë vetëm një numër i kufizuar i personave dhe atë me autorizimin e menaxhmentit.
- Të vendosë dhe të kontrollojë tarifat dhe normat e taksave në sistem në mënyre që të llogaritë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Të ekzistojë një lidhje automatike ndërmjet sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyre që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.
- Të ushtrojë barazime të rregullta në mes të dy sistemeve në periudha të rregullta për të gjitha tipet e të hyrave. Në rastet kur ka diferenca, ato duhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brenda një afati të caktuar.
- Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta ndërmjet tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksioneve.

### 2.3.4 Përgjigja e menaxhmentit

Komuna është e çertifikuar të aplikoje tatimin në pronë, dhe bën faturimin e obligimeve plotësisht sipas dispozitave ligjore. Tipet e tjera të të hyrave janë taksat, të cilat duhen kuptuar si kundërvlerë e shërbimeve që Komuna ju kryen personave fizike apo juridike, dhe për të gjitha rastet ekziston faturimi. Ne mendojmë se është bërë një ngaterrim i te kuptuarit në mes të tatimit dhe taksës. Është e padrejtë ti faturohët taksa një biznesi para se atij t'i kryhet shërbim nga komuna per dhenien e lejës së punës apo operimit.

Komuna komunikon me MTI dhe si provë ju kemi ofruar regjistrin e bizneseve të licencuara për komunën e Drenasit. Vlen të theksohet se Komuna bën percjelljen e veprimtarisë së bizneseve përmes Inspekcionit dhe i detyron që të vijne në Komune për tu pajisur me leje. Ky sherbim paguhet në emër të taksës komunale e rregulluar më rregullore e cila është e çertifikuar nga niveli qendror. Është plotësisht antiligjore ti faturosh taksa biznesit para se ti kryesh shërbimin.

Ne ju kemi ofruar dhe prapë ju ofrojme deshmite e barazimit të të hyrave në mes të drejtorive që arketojne të hyra me zyrtarin e të hyrave. Sic e dini dhe ju ne Kosovë ende nuk kemi një plan kontabël për regjistrimin e të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve .

## 2.4 Shpenzimet

### 2.4.1 Vëzhgimi

*Pagat dhe mëditjet*

- Në rastet kur një mësues jep dorëheqjen duhet të paktën një muaj që zyra e personelit të njoftojë Ministrinë e Shërbimeve Publike në mënyrë që Ministria të mund të reflektojë ndryshimin në listën e pagave. Duke pasur një vonesë të tillë, një mësues mund të vazhdojë të marrë kompensim edhe pas largimit.
- Komuna nuk ka një sistem për pagat i cili mund të përdorej si informacion i besueshëm për ti mbështetur të dhënat ne pasqyrat financiare. Në vend të kësaj, si informacion kryesor dhe i besueshëm përdoren listat e pagave të dërguara nga Ministria e Shërbimeve Publike.
- Në dosjet e personelit te cilat ishin pjesë e testimit tonë, ne nuk kemi gjetur asnjë dokument për kërkesë promovimi apo autorizimin vendimi për ngritjen e koeficientit te kompensimit. Për më tepër ne kemi një rast kur vendimi për marrjen e një punëtori eshte pas datës se kontratës se tij.

*Procedurat e prokurimit*

- Projekti për ndërtimin e rrugës "Arllat - Vuqak", është autorizuar pa inicimin paraprak të procedurave të prokurimit. Në vitin 2007 kryetari ekzistues i komunës së Drenasit ka autorizuar gojarisht kompaninë e ndërtimit “Durimi” për kryerjen e punëve në projektin e lartëpërmendur. Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2007 kryetari i ri i Drenasit në mungesë të dokumentacionit për zotim mjetesh, kontratës për këtë projekt me punëkryersin dhe domunentacionit përkatës të kërkuar me ligjin e prokurimit publik ka refuzuar të paguajë kompaninë “Durimi” për punët e kryera.

  Sipas një padie qe kompania e ndërtimit ka plotësuar, gjykata ka vendosur qe Komuna duhet të paguajë faturën prej EUR 240,000 të datës 29 Mars 2008.

  Komuna nuk pati kundërshtim per kete vendimi dhe pagesa u ekzekutua nga departamenti i thesarit. Momentalisht rasti po hetohet më tutje nga agjencia Anti-Korrupsion.

### 2.4.2 Rreziku

Edhe pse gjetjet e lartpërmendura nuk kanë efekt material në pasqyrat financiare, mungesa e komunikimit në kohë dhe aprovimit nga autoritetet përkatëse ose mungesa e dokumentacionit në dosje mund të çojë në mospërputhje me Legjislacionin dhe kërkesat Rregullatore.

### 2.4.3 Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

### 2.4.4 Përgjigja e menaxhmentit

Nuk ka komente.

# 3 Çështjet e ngritura vitin e kaluar

## 3.1 Vëzhgimet e vitit të kaluar

*Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar*

1. Pasqyrat financiare të Komunës të dhëna në Shtojcë të këtij raporti janë jo të plota dhe balancat në shënimet e raportit nuk i mbështesin balancat nga pasqyrat financiare të këtij raporti dhe kështu nuk janë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Neni 41: Raportimi final i buxhetit nga Ligji mbi menaxhmentin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 2003/2, përshkruan saktësisht formatin dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të komunës. Në pasqyrat financiare të Komunës pjesa 16 shënimi 27 përmbledhja e aseteve jo financiare në pronë të organizatës buxhetore mungon.
2. Bazuar në procedurat e auditimit të performuara ne identifikuam se barazimi i të hyrave në mes të departamentit të taksave të komunës dhe departamentit të kontabilitetit nuk është kryer.Gjithashtu, ne identifikuam se barazimi i të hyrave në mes të pasqyrave financiare të komunës dhe të dhënave të kontabilitetit të komunës nuk është bërë.
3. Komuna nuk mban një regjistër të ndarë të aktiveve fikse. Shtuar kësaj nuk ka dëshmi mbi regjistrimin dhe ekzistencën fizike të mjeteve themelore deri më 31 Dhjetor 2007 dhe nuk është bërë barazimi në mes të numërimit fizik dhe librave të komunës.
4. Menaxhmenti i Komunës nuk mban libër ndihmës të debitorëve të saj lidhur me statusin e arketimit te taksave të ndryshme siç janë; taksa vjetore në pronë, taksa vjetore për licencat e biznesit, pjsëmarrja vjetore për bursa, qiraja për përdorimin e pronës komunale etj. Pa të dhëna të mjaftueshme dhe të detajuara të debitorëve, komuna nuk ka mundësi të krijojë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, po ashtu edhe arketimin e të hyrave vetanake në kohë.

*Percaktimi dhe efektiviteti operativ*

5. Bazuar në procedurat e auditimit të kryera në departamentin e edukimit ne identifikuam diferencat në mes të hyrave të faturuara dhe të arkëtuara nga kopshti i fëmijëve. Shtuar kësaj dhe lidhur me arkëtimin e të hyrave nga shkolla e mesme “Fehmi Lladrovci” ne gjetëm që nuk ka dëshmi mbështetëse për kategorizimin e atyre që paguajnë dhe që nuk paguajnë ata që janë të liruar nga detyrimet e pagesës.
6. Bazuar në procedurat e auditimit të kryera në Departamentin e Shëndetësisë në identifikuam parregullsi të caktuara të prezantuara në vijim;

   - të hyrat janë mbledhur në bazë të parasë në dorë;
   - regjistrimet e transaksioneve financiare nuk harmozinohen me raportet mujore; dhe
   - nuk është bërë barazimi i diferencave në mes të dhënave të marrura nga departamenti i shëndetësise dhe departmenti i kontabilitetit.
7. Bazuar nga inspektimi ynë i shpenzimeve të caktuara lidhur me shpenzimet e karburantit, mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, ne gjetëm që komuna ka mungesa në procesin e autorizimit. Burimet e informacionit subjekt i inspektimit tone nuk përmbajnë dëshmi të aprovimit mbi pranushmerinë nga personat e autorizuar.

*Pajtueshmëria me legjeslacionin dhe rregulloret*

8. Duke kontrrolluar dosjet e punëtorëve ne gjetëm një numër të rasteve të dosjeve të pakompletuara si mungesë të dokumenteve mbështetëse siç janë ato të ndryshimit të rrogave, kontratat e punetorve dhe kriteret e përzgjedhjes së punëtorëve.

9. Bazuar kontrollin tonë të kryer në Departamentin për Rini, Sport dhe Kulturë ne gjetëm parregullsi të caktuara lidhur me pagat në para në dorë siç janë:

   - donacioni në para për sofrën e poezisë “Ymer Elshani” në shumë prej 1,860 Euro
   - donacioni në para për Humoriaden në shumë prej 1,799 Euro.

   Kjo nuk është në pajtueshmëri me rregulloren administrative 2003/2 për menaxhimin e fondeve publike, dhe nenin 9.3 nga rregullativa financiare dhe manuali i parasë se gatshme për shpenzimet e fondeve publike numër 2006/2 i cili saktëson qartë se shpenzimet më të mëdha se 100 Euro nuk mund të paguhen me para në dorë.

10. Nga kontrolli i dokumenteve burimore lidhur me procedurat tenderuese për ndërtimin e rrugës Drenas-Arbri-Drenas, kontrata numër 611-07-018-81 ne gjetëm parregullsi të caktuara. Puna sipas kontratës do duhej të përfundonte me 10 Gusht 2007 megjithatë kontrata është shtyrë për tre muaj dhe është përfunduar me 17 Nëntor 2007. Sipas pikës 7 të kontratës nëse punët e specifikuara në kontratë nuk janë përfunduar në afatet e parashikuara, OE do të gjobitet me 0.1% nga shuma e kontratës në ditë apo 0.5% në javë; ose shuma totale që duhet kompensuar do të jetë 10% e kontratës. Gjatë shqyrtimit ne identifikuam që gjobat për shtyrje të projektit nuk janë vendosur.

## 3.2 Statusi në këtë vit

- Status këtë vit për gjetjet ne pkat 1 dhe 3 është i detajuar ne pikat e sivjetshme 2.1 dhe 2.2.
- Vëzhgimet për pikat 2 dhe 4 deri 10 me lart, te cilat lidhen me te hyrat, shpenzimet dhe procedurat ndërlidhëse, janë te detajuara ne statusin e këtij viti ne pikat 2.3 dhe 2.4.

# Shtesa 2

**Forma te ndryshme te Opinioneve te Auditimit te perdorua nga Zyra e Auditorit Gjeneral ne Raportin e Auditimit Vjetor per vitin 2009**
(Marre nga ISSAI 4000)

9. Nje opinion auditimi normalisht jepet ne nje format standart, dhe lidhet me pasqyrat financiare ne teresi, duke evituar keshtu nevojen per te sqaruar gjeresisht se cfare qendron pas tij, por duke bere te mundur per lexuesit nepermjet llojit te tij, te kuptuarit e pergjithshem te domethenies se tij. Natyra e fjaleve do te ndikohet prej kuadrit ligjor per auditimin, por permbajtja e opinionit do te jete e nevojshme te tregoje qarte nese eshte i pakualifikuar apo i kualifikuar dhe, nese eshte i kualifikuar, eshte i kualifikuar per disa aspekte apo eshte nje opinion kunder (paragrafi 14) ose nje refuzim per te dhene opionion (paragrafi 15).

10. **Nje opinion i pakualifikuar** jepet kur audituesi eshte i kenaqur ne cdo aspekt material per sa vijon:
(a) Pasqyrat financiare jane pergatitur duke perdorur baza kontabel te pranueshme dhe politika te cilat jane zbatuar ne menyre te qendrueshme;
(b) Pasqyrat jane ne perputhje me kerkesat statutore dhe regulloret perkatese;
(c) Sipas njohurise se audituesit mbi njesine e audituar, pamja e paraqitur nga pasqyrat financiare eshte e qendrueshme; dhe
(d) Pasqyrat financiare permbajne shpalosjet e duhura te informacionit per te gjitha ceshtjet materiale.

11. **Terheqje e vemendjes**. Ne disa rrethana audituesi mund te mendoje se lexuesi nuk do te jete ne gjendje te kuptoje drejt pasqyrat financiare nese atij nuk i terhiqet vemendja per ceshtje te rendesishme apo te pazakonta. Si parim i pergjithshem, audituesi qe jep nje opinion te pakualifikuar nuk u referohet aspekteve te pasqyrave financiare ne opinion, nese ky do keqinterpretohej si nje kualifikim. Me qellim evitimin e dhenies se kesaj pershtypje, referimet qe kane kuptimin e “terheqjes se vemendjes” paraqiten ne nje paragraph te vecante prej opinionit. Megjithate, audituesi nuk duhet te perdore nje terheqje vemendje per ceshtje te cilat lidhen me mungesen e shpalosjes se duhur te informacionit ne pasqyrat financiare, dhe as si nje alternative apo zevendesuese te kualifikimit te opinionit.

12. Nje auditues mund **te mos jete ne gjendje te shprehe nje opinion te pakualifikuar nese** ekziston ndonje prej rrethanave te meposhtme dhe sipas gjykimit te audituesit efekti i tyre ne pasqyra financiare eshte ose mund te jete material:
(a) Ka pasur kufizim te qellimit te auditimit;
(b) Audituesi konsideron nese pasqyrat jane te paplota ose keqinterpretuese, ose nese ka nje shmangie te pajustifikuar nga standartet kontabel te pranuara; ose
(c) Ka pasiguri qe prek pasqyrat financiare.

13. **Opinion i kualifikuar**. Kur audituesi nuk eshte dakord ose eshte i pasigurt per nje ose me shume zera te vecante te pasqyrave financiare, te cilet jane materiale por jo thelbesore per te kuptuar pasqyrat, duhet dhene nje opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon nje rezultat te kenaqshem per auditimin, subjekt ky i nje deklarate te qarte dhe koncize per ceshtjet per te cilat audituesi ka kundershtim apo te cilat krijojne pasiguri qe sjellin kualifikimin e opinionit. Percaktimi sasior i efektit financiar qe vjen prej pasigurise apo kundershtimeve nga ana e audituesit, i ndihmon perdoruesit e pasqyrave, megjithese ky nuk eshte gjithmone i mundur apo i rendesishem.

14. **Opinion kunder**. Kur audituesi nuk eshte ne gjendje te krijoje nje opinion mbi pasqyrat financiare te marra ne teresi, per shkak te kundershtive kaq thelbesore sa e demtojne prezantimin e pozicionit ne masen qe nje opinion i kualifikuar vetem per disa aspekte do te ishte i papershtatshem, jepet nje opinion kunder. Formulimi i nje opinioni te tille ben te qarte se pasqyrat financiare nuk jane te paraqitura ne menyre te drejte, duke specifikuar qarte dhe shkurt te gjitha ceshtjet e kundershtuara. Perseri, percaktimi sasior i efektit financiar ndihmon perdoruesit e pasqyrave, nese nje gje e tille eshte praktike dhe e rendesishme.

15. **Refuzim per te dhene Opinion**. Kur audituesi nuk eshte ne gjendje te krijoje nje opinion mbi pasqyrat financiare te marra ne teresi, per shkak te nje pasigurie apo nje kufizimi te qellimit, kaq thelbesor sa nje opinion i kualifikuar vetem per disa aspekte do te ishte i papershtatshem, jepet nje refuzim per te dhene opinion. Formulimi i nje refuzimi te tille ben te qarte se nuk mund te jepet nje opinion, duke specifikuar qarte dhe shkurt ceshtjet e pasigurta.

16. Per SAI eshte e zakonshme qe te jepet nje raport i detajuar qe sqaron opinionin ne rrethana kur nuk eshte e mundur te jepet nje opinion i pakualifikuar.

## II. DEKLARATË PËR PREZANTIMIN E PASQYRAVE FINACIARE

Për: **Lulzim Ismajli, Drejtor i Thesarit**
Nga: **Sekretari Permanent (Kryeshefi Ekzekutiv)**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë edhe shënimet për këto pasqyra, për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2008 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 2003/02 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës të Komunës se Drenasit për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2008.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:

Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.

Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.

Nuk ka llogari bankare të BKK-së përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2008.

Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare, në rast se do të shkeleshin.

Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.

Të gjitha huatë për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.

Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Komunat duhet të dërgojnë raportet te komisioni për buxhet dhe financa të Asamblesë Komunale.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2008 të Komunës së Drenasit.

**Data:**
**Nënshkrimi dhe vula:**
**Sekretari Permanent ( Kryeshefi Ekzekutiv)**

# Komuna e Drenasit
## Neni 9. Raporti i Buxhetit
## për vitin qe mbaron me 31 Dhjetor 2008

*(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)*

**Raporti i Buxhetit**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar Rregullorja 2008/13 | Buxheti me Rishikim Urdhëresa Administrative 03/L-093 | Buxheti përfundimtar Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës ('SIMFK') | Ndryshimet ne % | Ndryshimet ne % | Ndryshimet ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **A** | **b** | **c** | **d** | **e=(c-b)/b** | **f=(d-b)/b** | **g=(d-c)/c** |
| **Gjithsej Buxheti 2008** | **4,985** | **5,260** | **5,866** | **1.06** | **1.18** | **1.12** |
| Rrogat dhe Pagat | 3,276 | 3,334 | 3,495 | 1.77 | 6.68 | 4.83 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 822 | 836 | 839 | 1.70 | 2.07 | 0.36 |
| Shpenzimet Komunale | 133 | 133 | 133 | - | - | - |
| Subvencione dhe Transferet | 73 | 73 | 91 | - | 24.66 | 24.66 |
| Investimet Kapitale | 681 | 884 | 1,308 | 29.81 | 92.07 | 47.96 |

**Raport buxheti duke përfshirë edhe grantet donatore**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar Rregullorja 2008/13 | Buxheti me Rishikim Urdhëresa Administrative 03/L-093 | Buxheti përfundimtar SIMFK | Ndryshimet ne % | Ndryshimet ne % | Ndryshimet ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **b** | **c** | **d** | **e=c/b** | **f=d/b** | **g=d/c** |
| **Gjithsej Buxheti 2008** | **4,985** | **5,260** | **5,903** | **5.52** | **18.42** | **12.22** |
| Granti i përgjithshëm | 4,519 | 4,647 | 4,808 | 2.83 | 6.40 | 3.46 |
